



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr. 230/ Prot.
2.1

Patos, më 15/04/2022

PROCES-VERBAL

I mbajtur sot në datë 14.04.2022 ora: 12:00 në ambientet e Njësisë Administrative Zharrëz organizohet takimi konsultativ me përfaqësues të shoqërisë civile dhe grupe interesi lidhur mbi marrjen e kërkesave prioritare për hartimin e "PBA-2023-2025".
Pjesëmarrës në këtë mbledhje janë:

1. Përfaqësues të Këshillit Bashkiak
2. Kryetarë të fshatrave
3. Fermerë të zonës
4. Përfaqësues të ekzekutivit të Bashkisë
5. Përfaqësues të projektit Bashki të Forta

Takimi hapet nga Këshilltari Ervis Rucaj

Ervis Rucaj – mirëdita, ju falenderoj për prezencën tuaj në këtë takim konsultativ lidhur mbi marrjen e kërkesave prioritare për buxhetin afartmesëm. Ne jemi të hapur dhe në pritje të cdo mendimi syjerimi apo edhe vrejtjeje për punën e bërë jo vetëm nga Bashkia por edhe nga Këshilli. Fjala është për ju.

Balil Balili – më lejoni që përpara se të kalojmë më marrjen e kërkesave buxhetore t'ju sqaroj se kjo është fazë e parë e marrjes së kërkesave të cilat pas kësaj faze në të treja njësitë do të përpunohen dhe do t'i adresohen ekzekutivit për relatin ku do të janë për cdo njësi të ndara kërkesat prioritare. Ne kemi eksperiencë efektive dhe kërkesat tuaja janë marrë parashysh nga Bashkia duke i pasqyruar ato në investime. Të gjitha takimet konsultative kanë për synim transparencën e pushtetit vendor me qytetarët e tij por padyshim edhe për të fituar besimin e qytetarëve të vet. Hartimi i një buxheti kërkon një punë të madhe dhe një angazhim imenjativ qytetar duke filluar qysh tani e deri në fund të vitit ku në këshill vjen drafti përfundimtar i buxhetit. Tani fjala është për ju lidhur mbi cdo sygjerim apo propozim për buxhetin.

Luan Hoxha (Kryetari i fshatit Verbas)- komuniteti ka vërtet shumë nevoja dhe padyshim që jo të gjitha mund të realizohen në një vit por ne kemi një problem madhor për hapjen e rrugëve të parcelave pasi fermeri nuk arrin dot të marri podhimin e tij atje ku është toka dhe mospasja e njw tregu ndikon shumw nw falimentimin tonw pasi nuk kemi ku tw shesim prodhimin dhe kwto janw kërkesa tw përsëritura.

Amza Grëmbi – (Kryetari i fshatit Belinë) – me të drejtë e ngre shqetësimin kryetari i fshatit pasi ju vini na dëgjoni por nuk janë marrë të gjitha kërkesat tona parasysh, si p.sh: lidhur mbi rrugën për në hyrjen e fshatit Beninë nuk është bërë asnjë dhe kjo është kërkesë e përsëritur.

Polikseni Tupa – ky investim është i planifikuar në buxhetin e viti 2022

Amza Grëmbi – jo vetëm rruga është shqetësuese por edhe ndricimi është një problem madhor

Balil Balili – cdo investim i cili është parashikuar në buxhet do të bëhet patjetër

Amza Grëmbi – ju duhet të kuptoni se për ne dhe për më tepër për fermerët e fshatit Belinë të cilët kanë sera është një problem madhor mos pasja e rrugëve të parcelave.

Për buxhetin afatmesëm kërkoj që në fshatin Belinë të parashikohet ndërhyrja për Kanalizim të Ujrale të Zeza; - të ndëhyet për pastimin e kanaleve vaditës si dhe vendosja e një pompe në fund të tij; - të ndërhyet apo negociohet me qeverinë për uljen e cmimeve të plehrave pasi për një fermer i cili nuk ka burim tjetër të të ardhurave vec tokës i bie të falimentojë.

Namik Plepi (kryetari fshatit Novoselë)- problemi i rritjes së cmimeve të plehrave bujqësore është emergjent dhe mendoj se nw njksi duhet tw ketw njw zyrw apo njw pikw kontakti ku ne mund tw ankokemi pasi wshtw i padrejtw ngritura e cmimeve.

Ervis Rucaj – rritja e cmimeve është një problem kombëtar ndaj jam plotësisht dakord me ju pasi mendoj se duhet të ngrihet një bord transparence për marjen e masave lehtësuese dhe në dijeninë time ky shqetësim është ngritur nga të gjitha bashkitë e vendit.

Gramoz Baha – kërkoj të ndërhyet për pastrimin e kanaleve kullues pasi unë përvec tokës time kam marrë edhe tokë me qira, dhe i gjithë prodhimi më përmbytet.

Irakli Zarka(kryetari fshatit Frashër)- cfarë është bërë me banesat e dëmtuara të për të cilat këshilli ka miratuar një fond?

Shkëlqim Beqiraj –nga Ministria e Financës është kërkuar informacion lidhur mbi numrin total të famileve me banesa të dëmtuara dhe ne jemi të duke punuar me hartimin e projekteve për tu bërë pjesë e programave mbështetëse me bashkëfinancim për familijet në nevojë me ne. Ne si bashki kishim të përfshirra rikonstrukcionin e këtyre banesave por vetëm me një pjese të investimit me fontet tona por me implementimin në këto programe do të kërkojmë që të kemi një financim të plotë të rikonstrukzionit total të këtyre banesave .

Barjam Hazizaj (kryetar i fshatit Zharrëz) - për fshatin Zharrëz kërkoj të ndërhyret për rikonstruksion te rruga në lagjen "Belulaj"

Polikseni Tupe – ajo rrugë është parshikuar për investim në këtë vit kalendarik dhe do të bëhet patjetër

Barjam Hazizaj – përsëri mbështets shqetësimin e kolegëve lidhur mbi rrijtjen e cmimeve të plehrave.

Irakli Zarka – kërkoj të lahen kanalet në fshatin Frashër pasi janë të bllokuara


Gazment Baha- unë si fermer kërkoj hapje të rrugëve për në parcelat bujqësore

Balil Balili – unë ju falenderoj për të gjitha kërkesat e ngritura të cilat padyshim do të përpunoohen pas fazës së parë të konsultimeve dhe këshilli do t'i drejtohet bashkisë me një raport pas përfundimit të kësaj fazë dëgjesash duke i u paraqitur kërkesat tuaja në këto takime. Sic dhe jua thashë edhe në fillim sot me ne është edhe përfaqësuesi i projektit Bashki të Foerta z. Robert i cili kërkon të thotë dicka. Z. Robert fjala është épër ju

Robert Murati – faleminderit Balil, kur mora ftesën për të qenë pjesë e këtij takimi konsultativ nuk hezitova aspak për të qenë këtu për të parë nga afër se sa bashkia është transparente me ju edhe përmes këtyre takimeve konsultative të cilat kanë një qëllim thelbësor, krijimin e urave të drejtëpërdrejta të bashkëpunimit mes qytetarit dhe pushteti vendor. Ajo që unë doja t'ju sugjeroja është që të bëni ankesa dhe peticione lidhur mbi problemet tuaja të drejtuara jo vetëm bashkisë por mbi të gjitha këshillit pasi ai është organi i cili do të marri vendime për një cështje të caktuar. Ndaj ne duhet të dimë se kujt duhet t'ia adresojmë kërkesën apo ankesën tonë psh. në rastin e qytetarit i cili ka 50dylym tokë dhe i përballet vazhdimi i bashkisë duke i sjellë dëme të konsiderueshme në prodhim pasi kanalet kullues nuk funksionojnë plotesisht apo janë të pastruara pjesërisht atëherë kryetari i fshatit duhet ti drejtohet me një kërkesë duke marrë edhe firmat e bashkëfshatarëve të tij, këshillit të bashkisë dhe jam e bindur që do të ketë reagim. Gjithashtu unë ju sygjero që të ndiqni edhe faqen bashkisë ku janë të pasqyrauara priorititetet e bashkisë dhe në momentin që je duke e ndjekur uebsardin e bashkisë shikon se cfarë nuk është parashikuar në zonën tënde të banimit. Gjithashtu është edhe opzioni i peticionit të këshillit online ju mund ta shfrytëzoni.

Balil Balili – Faleminderit Robert, nëse ndonjëri prej jush ka dicka për të shtuar lidhur mbi kërkesat prioritare? Mqse jo edhe një herë faleminderit dhe mirë u takofshim në takime të tjera.

**Koordinator
Për Konsultimin Publik
Suzana Hysenaj**



Adresa: Lagja "Naftëtari", Rruga "Unaza", Patos